



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:242767
Datë: 24.04.2024
Numri i dokumentit: 05614819

A.C.nr.1066/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi kryetar, Arsim Hamzaj dhe Naim Mehulli, anëtarë, në çështjen juridike të paditësve B.G. dhe A.A-G., që të dy me vendbanim në rr. "...", Komuna Prishtinë, të cilët i përfaqëson me autorizim "M.B.N", Sh.P.K., me avokat B.S., me seli në rr. "...", Komuna Prishtinë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "P...", me seli në rr. ..., Komuna Prishtinë, në çështjen për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësve, të parashtruar kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, divizioni civil, C.nr.3722/2017 datë 21.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 24.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET ankesa e paditësve B.G. dhe A.A-G., që të dy me vendbanim në rr. "...", Komuna Prishtinë, e ushtruar kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, divizioni civil, C.nr.3722/2017 datë 21.12.2023, e **PA LEJUESHME**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.3722/2017 datë 21.12.2023, ndër të tjera ka vendosur si vijon:

“... I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia paditësve B.G. dhe A.A-G. nga Prishtina ashtu që DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “P...” me seli në Prishtinë, që paditësve në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material, të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 28.10.2017, t’ia paguaj shumat si vijon:

- Për paditësin B.G.:

a) në emër të dëmit jo material:

-Në emër të dhimbjeve fizike, shumën prej..... 700.00 €

-Në emër të frikës së përjetuar, shumën prej..... 600.00 €

b) në emër të demit material:

-Në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj, shumën prej150.00 €

-Në emër të ushqimit të përforcuar, shumën prej100.00 €

Gjithsej shumën prej: 1,550.00 €

- Për paditësen A.A-G.:

a) në emër të dëmit jo material:

-Në emër të dhimbjeve fizike, shumën prej..... 700.00 €

-Në emër të frikës së përjetuar, shumën prej..... 600.00 €

b) në emër të demit material:

-Në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj, shumën prej150.00 €

-Në emër të ushqimit të përforcuar, shumën prej100.00 €

Gjithsej shumën prej: 1,550.00 €

II. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “P...”, që shumat e gjykuara në pikën -I-, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t’ia paguan paditësve me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë për kompensim dëmi data 27.12.2017 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës, në shumën prej 1,324.40 €, (një mijë e treqind e njëzet e katër euro e katërdhjet cent), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.

III. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve mbi shumat e aprovuara si në pikën I, dhe atë: për paditësin B.G. në emër të dhimbjeve fizike shumën prej 1,300.00 €, në emër të frikës së përjetuar shumën prej 1,400.00 €, në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj shumën prej 50.00 €, në emër të ushqimit të përforcuar, shumën prej 100.00 €, si dhe në tërësi kërkesëpadinë në emër të rehabilitimit fiziko - terapeutik shumën prej

400.00 € si dhe për paditësen A.A-G., në emër të dhimbjeve fizike, shumën prej 1,300.00 €, në emër të frikës së përjetuar shumën prej 1,400.00 €, në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj shumën prej 50.00 €, në emër të ushqimit të përforcuar, shumën prej 100.00 €, si dhe në tërësi kërkesëpadinë në emër të rehabilitimit fiziko – terapeutik, shumën prej 400.00 €...”.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë i autorizuari i paditësve, për shkak të: zbatimi të gabuar të së drejtës materiale sa i përket lartësisë së kompensimit dhe llogaritjes së kamatës, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar dhe të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur e paditura me propozim që të refuzohet ankesa e paditësve dhe të vërtetohet aktgjykimi i ankimuar.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe parashtresën e paditësve për tërheqje të ankesës e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 195 par.1 pika a) të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, gjeti se :

- Hedhet ankesa si e palejueshme.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve pasi që ka administruar provat ka vendosur që ta aprovoj pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve duke vendosur më shumë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Paditësit me datë 29.12.2023, kanë parashtruar ankesë, duke e kundërshtuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë C.nr.3722/2017 datë 21.12.2023.

I autorizuari i paditësve me datë 13.02.2024, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, ka parashtruar parashtresë më të cilën e tërheq ankesën e parashtruar kundër aktgjykimit C.nr.3722/2017 datë 21.12.2023, me të cilën është aprovuar pjesërisht kërkesëpadia e paditësve.

Andaj bazuar në faktin se paditësit e kanë tërhequr ankesën, Gjykata e Apelit e ka hedhur ankesën si të palejueshme, duke u bazuar në nenin 186 paragrafi 1 e lidhur me paragrafin 3 të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se : *“ankesa është e palejueshme po që se e ka parashtruar personi që nuk është i autorizuar për paraqitjen e saj, apo personi që ka hequr dorë nga e drejta e ankimit apo që e ka tërhequr ankesën e paraqitur, apo në qoftë se personi që e ka paraqitur ankesën nuk ka interes juridik për paraqitjen e ankesës”.*

Numri i lëndës: 2019:242767
Datë: 24.04.2024
Numri i dokumentit: 05614819

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi e në kuptim të nenit 209 pika (a) të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore.

GJYKATA E AELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
A.C.nr.1066/2024 datë 24.04.2024

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari,
Bujar Muzaqi